

NEWSLETTER No.3

“BUILDING COMMUNITIES OF KNOWLEDGE FOR COMPETITIVE MSE-S”

Priority Axis 1. Entrepreneurship & Innovation – Sp. Objective 1.3 Territories of Knowledge,
Project No. 1848, Subsidy Contract No BMP1/1.3/1848/2019,
Interreg V-B “Balkan – Mediterranean 2014 – 2020”

LANCIMI I PROJEKTIT

STUDIMI: “ANALIZA E NEVOJAVE PËR TRAJNIM”

Në kuadër të Projektit "Krijimi i një platforme me njohuritë e nevojshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në treg" (skills4MSEs), Fondacioni ABC kreu një studim me qëllim identifikimin e nevojave për trajnim të sipërmarrësve aktualë dhe atyre potencialë.

Nga të dhënat e studimit evidentohet që ekzistojnë mundësi potenciale për trajnim dhe rritje të aftësive potenciale në fusha të tilla si kontabilitet, logjistikë, prodhim, gjenerim të ideve novative, kreativitet, menaxhim të konfliktit në biznes, punë në grup, etj.

Gjithashtu nga të dhënat e raportuara duket që ka mundësi për trajnim dhe rritje të aftësive në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në çështje të tilla të biznesit si; përdorimi i programeve të prezantimit (powerpoint), kërkimi për punë nëpërmjet internetit (p.sh. modelet e reja të CV si CV Europass), excel, zgjidhje e problemeve teknike në sistemet dhe teknologjitë e IT, zhvillimin e aplikacioneve në gjuhët e programimit, analizimin e të dhënave lidhur me biznesin (p.sh. Google Analytics), etj.

Kërkesë evidente mbetet nevoja për trajnim e sipërmarrësve aktualë dhe potencialë, në lidhje me aftësitë bazike dhe ato të avancuara të sipërmarrjes.

Dhe në fund, lidhur me nivelin e interesimit të bizneseve për një platformë në internet që ju ofron trajnime për të zhvilluar më tej aftësitë e përmendura më lart, pjesa më e madhe e sipërmarrësve të intervistuar shprehin një interes të konsiderueshëm për këtë platformë.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve, Fondacioni ABC, në kuadër të projektit do të zhvillojë materialet e trajnimit dhe të organizojë dhe zhvillojë trajnime specifike me grupe sipërmarrësish.



Zhvillimi i moduleve te trajnimit

Në kuadër të Projektit "Krijimi i një platforme me njohuritë e nevojshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në treg" – SKILLS4MSEs, gjatë studimit në lidhje me identifikimin e nevojave për trajnim të sipërmarrësve mikro dhe të vegjël, dolën në pah një sërë nevojash prioritare të trajnimit, siç janë: nevojat e aftësive të buta për trajnim, aftësitë e gjenerimit të ideve, planifikimi i biznesit, marketing, mënyra e adresimit të nevojave të financimit, etj.

Bazuar në identifikimin e nevojave për trajnim, ekspertët hartuan 10 module trajnimi si më poshtë:

1. Aftësi joteknike për sukses
2. Gjenerimi i ideve
3. Tregu dhe konkurrenca
4. Planifikimi i biznesit
5. Marketingu për NVM-të
6. Marketingu për fermerët
7. Inovacioni i Modelit të Biznesit
8. Mediat sociale
9. Hyrje në financimin fillestar
10. Hyrje në biznesin social

Projekti ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh dhe bashkë financohet nga Bashkimi Evropian dhe Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse.

ZHVILLIMI I TRAJNIMEVE

Gjatë muajit Prill 2021, kanë filluar trajnimet e para në kuadër të Projektit "Krijimi i një platforme me njohuritë e nevojshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në treg" (skills4MSEs).

Në datë 20 Prill 2021, u zhvillua në Elbasan trajnimi "Aftësitë joteknike për sukses në punë & biznes", me pjesëmarrjen e 16 sipërmarrësve të rinj.

Trajnimi përmbante informacion praktik mbi çështje që kanë të bëjnë me karakteristikat dhe aftësitë personale si dhe aftësitë analitike, krijuese dhe praktike të sipërmarrësit, të nevojshme për zhvillimin me sukses të biznesit.

Temat që u trajtuan janë si më poshtë:

- Aftësitë e buta dhe ndikimi i tyre në karrierën tone; Punë në ekip; Zgjidhja e problemit; Vëzhgimi kritik.
- Aftësitë profesionale jo-teknike

- Karakteristikat personale: Optimizimi, Vizioni, Iniciativa, Dëshira për kontroll, Këmbëngulja, Toleranca ndaj Rrezikut, Rezistenca
- Shkathtësitë ndërpersonale: Udhëheqja dhe motivimi, Aftësitë e komunikimit, Aftësia për të dëgjuar me vëmendje, Ndërtimi dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve personale, Aftësitë e Negocimit, Sjellja Etike.
- Aftësitë analitike: Të menduarit krijues, Zgjidhja e problemeve, Njohja e mundësive, Vendosija e qëllimit, Planifikimi dhe organizimi, Vendimmarrja, Njohuri specifike të zanatit, Njohuri specifike mbi sipërmarrjen
- Aftësitë sipërmarrëse: aftësitë e menaxhimit - aftësia për të menaxhuar me sukses kohën dhe njerëzit; aftësi komunikimi; aftësia për të shitur ide dhe për të bindur të tjerët; aftësia për të punuar në ekip dhe në mënyrë të pavarur; aftësia për të planifikuar,



- koordinuar dhe organizuar në mënyrë efektive; aftësitë themelore në financë; aftësia për të bërë kërkime efektive (p.sh., në tregjet në dispozicion, furnizuesit, klientët dhe konkurrencën); aftësia për të qenë i vetë-motivuar dhe i disiplinuar; aftësia për tu përshtatur; aftësi krijuese dhe mendim krijues; aftësia për të marrë përsipër shumë detyra; aftësia për të marrë përgjegjësi dhe për të marrë vendime; aftësia për të punuar nën presion; këmbëngulja; konkurrenca; gatishmëria për të ndërmarrë rreziqe; aftësia për të lidhur dhe për të bërë kontakte me të tjerët
- Disa aftësi të tjera më specifike ose specifike të biznesit: aftësia për të hartuar një plan biznesi për një sipërmarrje të re; aftësia për të lansuar dhe shitur një produkt ose ide të re; aftësitë financiare, të tilla si mbajtja e një ditari në kontabilitetin dhe llogaritjen e taksave; aftësitë njohëse dhe zbatuese të legjislacionit përkatës.
- Gjithashtu pesë aftësi shumë të nevojshme për sipërmarrësit janë: Aftësia për të vepruar në kushte të pasigurisë; Shkathtësi / njohuri mbi mjetet / praktikat e nevojshme të punës dhe aktivitetit në situata të ndryshme; Aftësia për të menduar ndryshe dhe për të konsideruar alternativa (të menduarit e dizajnit); Ndjeshmëri për klientin (i interesuar për të njohur dhe kuptuar perspektivën e klientit); Aftësia për të provuar gjërat ndryshe, kërkon prova të ideve, kryen teste, nxjerr mësim dhe vepron shpejt.
- Aftësitë kryesore të komunikimit: Inteligjenca emocionale; Qartësia dhe koherenca; Vetëbesim; Ndjeshmëri; Respekt; Të dëgjuarit; Mendje hapur; Gjuha e trupit.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit morën pjesë aktive dhe ndanë eksperiencë të ndryshme me njëri tjetrin. Falenderojmë pjesëmarrësit dhe i urojmë suksese në punën e tyre.



Fondacioni ABC zhvilloi trajnimin “Zhvillimi i ideve të biznesit”

Më datë 23 Prill 2021, Fondacioni ABC zhvilloi trajnimin “Zhvillimi i ideve të biznesit”, në kuadër të Projektit “Krijimi i një platforme me njohuritë e nevojshme për rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në treg” (skills4MSEs), projekt i cili po zhvillohet në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillimin e Biznesit dhe Kulturës, KEPA, Greqi si partneri kryesor dhe partnrë të tjerë si Universiteti i Maqedonisë - Departamenti i Informatikës së Aplikuar, Komiteti Kërkimor i UOM (ELKE), Greqi; Microfond Sofia Foundation, Bullgari dhe SHKK “FEDinvest” – Shqipëri

Trajnimi u zhvillua në Shëngjin, Lezhë, me pjesëmarrjen e 25 sipërmarrësve të rinj.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit u njohën me tema të tilla që kanë të bëjnë me mënyrën se si zhvillohen idetë e biznesit, çfarë duhet pasur parasysh për arritjen e qëllimit të sipërmarrjes, cilat mund të jenë rreziqet dhe dështimet e sipërmarrjes dhe si mund ti paraprijmë atyre në mënyrë që të minimizojmë pasojat negative, analiza e tregut dhe e industrisë ku do të zhvillohet sipërmarrja, cilat janë shanset dhe kërcënimet që mund të hasen gjatë zhvillimit të biznesit si dhe çështje të tjera për të cilat pjesëmarrësit ishin të interesuar.

Fondacioni ABC do të vazhdojë me trajnime të tjeragjatë muajve në vazhdim, informacionet mbi të cilat mund ti merrni në faqen e internetit apo në rrjetet sociale:

www.abcfoundation.info

info@abcfoundation.info

